

Kati numizmatik

1 Këmbimi Paramonetar

Për të kryer shkëmbimet, banorët prehistorikë përdornin sistemin e këmbimit mall me mall, për të vijuar më pas me përdorimin e objekteve të caktuara si paramonedhë.

3 Koleksioni Numizmatik shek. IV-XX p.e.s.

Prezanton koleksionet numizmatike të Bankës së Shqipërisë nga lashtësia në shek. XX.

2 Prerje monetare në Iliri

Historia e trojeve tona dëshmon prerjen e monedhave të para që në shekullin IV p.e.s.

4 Dhoma e Thesarit

E hapur për herë të parë për publikun më 2015, gjatë viteve 1938-2010, kjo dhomë ka ruajtur brenda saj pjesë të Thesarit të Shtetit: lingota ari, monedha të arta e të argjendta, gurë e stoli të çmuara.

5 Banka Kombëtare e Shqipërisë

Më 2 shtator 1925, u themelua Banka Kombëtare e Shqipërisë, sipas një marrëveshjeje mes Qeverisë Shqiptare dhe një grupi financiar italian.

6 Banka e Shtetit Shqiptar

Në 1945, u themelua Banka e Shtetit Shqiptar, e cila mbështeti zhvillimin e ekonomisë socialiste. Qendër emisioni e monedhës dhe krediti për ndërmarrjet, kooperativat bujqësore dhe individët.

7 Banka e Shqipërisë

Më 2 prill 1992, krijohet Banka e Shqipërisë si bankë qendrore e vendit. Tri banka të tjera shtetërore, u kthyen në banka të nivelit të dytë, duke krijuar sistemin bankar dy nivelor.

8 Ark. Vittorio Morpurgo

Arkitekti projektues i ndërtesës së Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë, Durrës dhe Korçë.

Si të orientohemi në Muzeun e Bankës së Shqipërisë?

Çfarë do të gjejmë aty?

Numizmatikë

Edukim financiar

Histori

Informacion


Aplikacione interaktive

Artefakte

Teknologji



MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË



Kati edukativ

1 **Holli historik i Bankës së Shqipërisë**

Në hollin historik ofrohet informacion historik mbi krijimin dhe rrugëtimin e bankës qendrore në Shqipëri (roli i bankës qendrore). Me rastin e inaugurimit të Muzeut është çelur ekspozita e përkohshme “Thesaret etnografike të Bankës së Shqipërisë”.

2 **Mozaiku**

Mozaiku i realizuar nga piktori italian Giulio Rosso, është një ndër pjesët më interesante të interierit të Bankës së Shqipërisë. Ai reflekton, si në një pasqyrë, klimën kulturore romane të asaj kohe.

3 **Holograma**

Në dhomën e hologramës mund të ndiqni, në hapësirë 3 dimensionale, një rrëfenjë monedhash antike. Rrëfenja të çon larg në kohë, tek qytetërimet e lashta, për të na dëshmuar mbi monedhat që kanë prerë dhe përdorur paraardhësit tanë.

4 **Dhoma e studentit**

Mësoni më shumë mbi mënyrën se si funksionon një bankë e nivelit të dytë dhe si qarkullon paraja në ekonomi. Në touchscreen-et e vendosura në dy kthina të veçuara, të interesuarit mund të marrin informacion audio-vizual përmes guidave dhe aplikacioneve, të ndjekin filma të shkurtër apo të provojnë njohuritë në kuizet tona.

5 **Dhoma e konferencave**

Për vizitorët në grup ofrojmë prezantime mbi bankën tonë qendrore dhe sistemin bankar e atë financiar. Gjithashtu, mund të ndiqni filma dokumentarë nga autorë me ekspertizë në fushën e ekonomisë e të financës, shpesh të vlerësuar me çmime prestigjioze.

6 **Dhoma e Evropës**

Njihuni me funksionet, rolin dhe historinë e Bashkimit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane, Eurozonës, marrëdhëniet Shqipëri-BE dhe rrugën tonë drejt integritimit evropian.

7 **Dhoma e Fëmijëve**

Për të gjithë fëmijët: lexoni dhe luani me aplikacionin interaktiv “Derrkuci Çufo mëson të kursejë”; provoni njohuritë në kuizin “Torta e Çufos” ose merrni pjesë, të organizuar në grupe, në një nga aktivitetet tona edukative.

8 **Dhoma e shitjes**

Ambienti ku koleksionistët por edhe të interesuarit e fushës numizmatike mund të blejnë monedha apo kartëmonedha.

9 **Printo kartëmonedhën me portretin tuënd**

